

Vendim nr. 190 datë 15.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 15.07.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 4 (T) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **TOM DEDAJ**, përfaqësuar nga avokat Gëzim Ndoj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Shpallja si antikushtetuese e pikës 2 të nenit 399/8 të Kodit të Procedurës Civile.
Miratimi i një shpërblimi të drejtë për kërkuesin në shumën 30 milionë lekë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 32, 42, 43, 49, 50, 51, 71, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 145 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8, 11 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 608 e vijues i Kodit Civil (KC); nenet 1, 68, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nga data 01.12.2013 deri në datën 01.11.2016, kur është pezulluar me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak se ndaj tij kishte filluar një procedim penal. Pas deklarimit fajtor të kërkuesit me vendim gjyqësor të formës së prerë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 22, datë 28.01.2019, ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra e prokurorit, vendim të cilin kërkuesi, në vijim, e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore.

2. Gjatë kohës së pezullimit nga detyra, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, drejtuesi i Prokurorisë Dibër ka nxjerrë urdhrin e datës 13.09.2017, në zbatim të të cilit kërkuesi është paguar me pagën minimale sipas përcaktimeve të nenit 110 të ligjit në fjalë. Në datën 30.11.2018 kërkuesit i është ndërprerë pagesa dhe, për këtë shkak, në datën 21.12.2021, ai ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dhënien e pagës nga data 01.12.2018 e në vazhdim, si dhe përqindjen e interesit për vonesat në dhënien e pagës.

3. Në datën 15.05.2024, gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim, ndërsa ajo vijonte të ishte ende në seancën përgatitore, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative të Apelit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), për të cilën ajo gjykatë, me vendimin nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024, ka vendosur rrëzimin e saj.

4. Kundër këtij vendimi, në datën 09.07.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual dhe me vendimin nr. 4, datë 21.01.2025 (*vendimi nr. 4/2025*), Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë me përparësi çështjen e kërkuesit.

5. Në atë gjykim, në parashtrimet për seancën plenare, kërkuesi ka kërkuar edhe shfuqizimin e pikës 2 të nenit 399/8 të KPC-së, si të papajtueshme me Kushtetutën, me pretendimin se cenonte të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë. Për këtë kërkim, Gjykata vlerësoi se përbën kërkim të veçantë, pasi shton njëkohësisht objektin dhe shkakun ligjor të ankimit dhe në kushtet kur është paraqitur pas kalimit të çështjes në seancë plenare nuk mund të merrej në shqyrtim, sepse duhej të respektonte kriteret e përgjithshme të formës dhe afateve dhe t'i nënshtrohej procedurës së shqyrtimit paraprak (*shih paragrafin 13 të vendimit nr. 4/2025*).

6. Në datën 08.05.2025, përmes shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.05.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar se:

- 7.1. Pika 2 e nenit 399/8 të KPC-së *cenon të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë*, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, pasi parashikon se vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë. Përveç kësaj, parashikimi i kësaj dispozite krijon problematikë me nenin 56 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, që përcakton vendimet e paankimueshme në Gjykatën e Lartë, ku nuk përfshihen vendimet sipas pikës 2 të nenit 399/8 të KPC-së.
- 7.2. Në bazë të neneve 608 dhe 609 të KC-së dhe të neneve 42, 43 dhe 44 të Kushtetutës, kërkuetit duhet t'i miratohet një shpërblim i drejtë në shumën e përcaktuar në objektin e kërkesës, përveç edhe shpenzimet gjyqësore për paraqitjen e saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje

Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në shtesë të kriterëve të mësipërme, rregullimet e veçanta për shqyrtimin e kërkesave përcaktohen nga neni 31/a, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000. Ato kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës, legjitimitimin formal të kërkuarit dhe të përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës. Një nga kriteret që përcakton kufijtë e juridiksionit të Gjykatës parashikohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të këtij ligji, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Ky rregull ligjor synon të garantojë sigurinë juridike, duke parandaluar kërkesat për rishqyrtimin e vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës nga të njëjtët kërkuar, për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat pretendime.

10. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është ligji ose akti normativ, Gjykata, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka pohuar se në këto raste kërkuar legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin për çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 85, datë 24.12.2024; nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji evidenton se mjafton mosplotësimi i njërit prej kriterëve kumulative që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të

elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Në rastin konkret, kërkuesi në objektin e kërkesës ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të: (i) vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit; (ii) pikës 2 të nenit 399/8 të KPC-së; si dhe (iii) miratimin e një shpërblimi të drejtë në shumën 30 milionë lekë.

13. Për kërkimin e parë të ankimit kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, Kolegji vëren se ky kërkim ka qenë objekt i vendimit të mëparshëm të Gjykatës, atij nr. 4/2025. Për rrjedhojë, ky kërkim nuk mund të merret më në shqyrtim, në kuptim të përmbajtjes së nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Për kërkimin e dytë të ankimit kushtetues individual, atij për shfuqizimin e pikës 2 të nenit 399/8 të KPC-së, e cila parashikon se për kërkesat për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë, Kolegji konstaton se kjo dispozitë është shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 05.05.2017, gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 98, datë 05.05.2017. Ndërkohë kjo dispozitë është zbatuar ndaj kërkuesit, pikërisht në rastin e vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit.

15. Kolegji vëren se neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se në rastet kur është e qartë se kërkuesi nuk ka asnjë mjet juridik efektiv, afati për t’iu drejtuar asaj fillon nga data e aktit të kundërshtuar ose data në të cilën ai është prekur drejtpërdrejt ose ka marrë dijeni për efektet negative të aktit (*shih vendimet nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 64, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rrethanat si më lart, duke mbajtur parasysh se dispozita ligjore e kundërshtuar për antikushtetueshmëri nga kërkuesi është zbatuar ndaj tij gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, të përfunduar në datën 19.06.2024, që përbën edhe momentin kohor të konstatimit nga ai të cenimit të pretenduar, si dhe faktin se ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 08.05.2025, pra pas gati 11 muajsh, Kolegji vlerëson se për kërkimin e dytë të ankimit kushtetues individual kërkuesi nuk plotëson kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

17. Për kërkimin e tretë të ankimit kushtetues individual, atij për shpërblimin e drejtë në shumën 30 milionë lekë, duke u bazuar në dispozitat përkatëse të KC-së për përgjegjësinë ndaj dëmeve jashtëkontraktore, Kolegji konstaton se kërkuesi, jo vetëm nuk tregon të drejtën kushtetuese ose ligjore të cenuar, por as provon që për mbrojtjen e saj të ketë përdorur mjetet juridike në dispozicion, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Edhe në supozimin se shpërblimi i drejtë kërkohet për shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm në rastin e procesit gjyqësor që lidhet me vendimin nr. 4/2025 të Gjykatës, kërkuesi nuk provon të ketë përdorur mjetet procedurale të disponueshme sipas parashikimeve të nenit 399/6, pika 3, të KPC-së.

18. Lidhur me kriterin e shterimit të *mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 50, datë 20.06.2024; nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rrethanat si më sipër, Kolegji vlerëson se, për sa kohë që nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, kërkuesi nuk e plotëson këtë kriter legjitimiteti për kërkimin e tretë, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Nga ana tjetër, në rastet e kërkesave për shpërblimin e drejtë të dëmit të shkaktuar nga zvarritja e procesit gjyqësor të zakonshëm, Gjykata, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës ka pohuar se pretendimet për të drejtën për dëmshpërblim, sipas neneve 399/6 dhe 399/10 të KPC-së, si rrjedhojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjyimit në gjykatat e zakonshme, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 31, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë

arsye, Kolegji çmon se kërkimi për shpërblimin e dëmit nga vonesa e procesit gjyqësor të zakonshëm nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.